



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS  
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 1281 Prot.

Tiranë, më 7 10 2019

**VENDIM Nr. 219, datë 2.10.2019**

Në mbështetje të *Ligjit Nr. 27/2018 "Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë"*, Neni 134, Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr. 11, datë 2.10.2019, pasi shqyrtoi Relacionin e verifikimit në terren në kuadër të projektit "*Rishikim të kushteve, ndërtimi i urës lidhëse dhe rehabilitimi i rrugës ekzistuese hyrëse në objektin "Ndërtimi i Nënstacionit të ri 110/20kV Tec Kombinat"*- subjekti OSHEE, realizuar nga Agjencia e Shërbimit Arkeologjik.

**VENDOSI:**

1. Të miratojë Relacionin e verifikimit në terren në kuadër të projektit "*Rishikim të kushteve, ndërtimi i urës lidhëse dhe rehabilitimi i rrugës ekzistuese hyrëse në objektin "Ndërtimi i Nënstacionit të ri 110/20kV Tec Kombinat"*- subjekti OSHEE, realizuar nga Agjencia e Shërbimit Arkeologjik.
2. Subjekti OSHEE duhet të lidhë paraprakisht akt-marrëveshje tre palëshe me subjekt të licencuar në arkeologji, i cili duhet të ndjekë në mënyrë periodike ditore kryerjen e punimeve të gërmimit për projektin "*Rishikim të kushteve, ndërtimi i urës lidhëse dhe rehabilitimi i rrugës ekzistuese hyrëse në objektin "Ndërtimi i Nënstacionit të ri 110/20kV Tec Kombinat"*", si dhe Agjencinë e Shërbimit Arkeologjik, cila do të mbikëqyrë këtë subjekt.
3. Investitori duhet të derdhë detyrimet tatimore për mbikëqyrjen e realizuar nga ASHA, sipas tarifave të miratuara me Urdhërin e Ministrisë Nr. 384, datë 21.10.2015 dhe përcaktimeve përkatëse të akt-marrëveshjes tre palëshe.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
5. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.



SEKRETAR I KKA  
RUBINA ZOTO